



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

K R Y E T A R I

Adresa: Kontrolli i Lartë i Shtetit Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; website www.klsh.org.al

Nr. 199/___ Prot.

Tiranë, më 22.08.2019

V E N D I M

Nr. 54, Datë 22.08.2019

PËR

AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË FUSHË-ARRËZ ME OBJEKT "AUDITIM FINANCIAR PËR PERIUDHËN 01.01.2017-31.12.2017 DHE PËRPUTHSHMËRIE (PROKURIMET DHE TË ARDHURAT) PËR PERIUDHËN 01.01.2017-31.12.2018.

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Fushë-Arrëz, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, jo të përhapura, në llogaritë vjetore, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar. Fusha kryesore në të cilat janë konstatuar gabime janë në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave në zhvillimin dhe në procedurat e prokurimit publik dhe zbatimit të kontratave të punimeve.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", me qëllim përmirësimin e gjendjes,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar në Bashkinë Fushë-Arrëz për periudhën 01.01.2017-31.12.2017 (auditim financiar) dhe për periudhën 01.01.2017-31.12.2018 (auditim përputhshmërie për prokurimet dhe të ardhurat), sipas programit nr. 199/1, datë 27.03.2019.

II. Të miratoj Opinionin e Auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITUESIT:

Opinionin i auditimit mbi pasqyrat financiare.

Për drejtimin e Bashkisë fushë-Arrëz.

Përgjegjësia e Auditit të KLSH-së, është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar. Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, mbështetur në standardet (ISSAI 1700)¹ dhe (ISSAI 1200)², shprehim një **opinion të kualifikuar** për llogaritë vjetore të Bashkisë Fushë Arrëz, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura. I njëjti opinion vlen edhe për pasqyrën e realizimit të buxhetit.

a-Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Bashkisë Fushë Arrëz, e cila përbëhet nga pasqyrat financiare (bilanci) të institucionit më 31 Dhjetor 2018, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare (cash-flow), pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, pasqyra e investimeve dhe burimet e financimit, pasqyra e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (kosto historike), pasqyra e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto), pasqyra e numrit të punonjësve dhe e fondit të pagave dhe pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.

Në rrethanat e mësipërme, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti i audituar mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare, duam të tërheqim vëmendjen **për opinionin e kualifikuar/me rezervë** (ISSAI 1705)³ të faktit se, jemi të pasigurt për disa çështje të konstatuara, të cilat janë *materiale* por jo të përhapura, me ndikim në vendimmarrjen e përdoruesit të pasqyrave financiare si:

Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2% për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar.

Duam të tërheqim vëmendjen tuaj **për opinionin e kualifikuar/me rezervë** të faktit se jemi të pasigurt për disa çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave si:

-Llogaria aktive e bilancit nr.31 “Materiale”, paraqitet në vlerën 85,530 lekë, regjistruar gabim pasi kjo vlerë duhet të regjistrohej në llogarinë 32 “Inventar i imët”. Vlëra e mësipërme përfaqëson materiale inventari të imët të njësisë Administrative Blerim, Në pasqyrën e inventarit kontabël të kësaj llogarie bashkangjitur pasqyrave financiare vlëra e llogarisë 32 “Objekte inventari” të gjendjeve të inventarit qarkullues në fund të viteve 2018 paraqitet në vlerën 9,772,624 lekë, kurse në aktiv të bilancit kjo llogari paraqitet në vlerën 9,687,094 lekë me diferencë në vlerën 85,530 lekë, vlerë kjo e barabartë me vlerën e llogarisë 31 “Materiale”. Vlëra prej 85,530 lekë e llogarisë 31 “Materiale”, duhej të ishte sistemuar në llogarinë 32 “Inventar i imët” në gjendjet e inventarit qarkullues.

-Llogaria aktive e Pasqyrave Financiare nr.20 “Aktive Afatgjata jo materiale” nuk pasqyron vlerën e saktë, për arsye se në këtë vlerë janë të përfshira edhe vlerat e projekteve, të cilat lidhen

¹ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

² Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

³ Kur gabimet janë materiale por jo të përhapura, audituesi paraqet një opinion të kualifikuar.

me investime të përfunduara prej vitesh, por kjo vlerë e projekteve nuk ka kaluar në vlerën e investimeve, duke rritur artificialisht vlerën e kësaj llogarie qysh nga ish komunat e në vazhdim. Kjo pasaktësi është e mbartur nga Bashkia Fushë Arrëz si dhe ish komunat, në momentin e shkrirjes së tyre si rezultat i reformës administrativo-territoriale. Për vitin 2018, paraqitet në vlerën 18,927,900 lekë, e cila përfaqëson vlerat e studim projekteve për investime në vite, nga shuma e mësipërme vlera 18,529,900 lekë i përkasin llogarisë 202 “Studime dhe kërkime dhe vlera 398,000 lekë i përkasin llogarisë 203 “Koncesione, patenta, licenca e të ngjashme”. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se disa studime e kërkime në vlerën 6,613,000 lekë, i përkasin investimeve për objekte të përfunduara në vitet e kaluara dhe të trashëguara nga 4 ish Komunat të cilat janë përthithur nga Bashkia Fushë-Arrëz. Kurse vlera prej 12,314,000 lekë i përkasin investimeve për objekte të përfunduara në vitet e kaluar e në vijim të Bashkisë Fushë-Arrëz. Vlera e këtyre objekteve, duhej të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit.

-Llogaria aktive e Pasqyrave Financiare nr.210 “Toka, Troje, Terrene”, paraqitet me zero lekë, e pa saktë, pasi nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se në këtë llogari nuk është pasqyruar: Vlera e trojeve të ndërtesave të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” si Godina e Bashkisë, Ndërtesat Shkolla e Mesme, Konvikti, Shkolla 9-vjeçare, ish-Ndërmarrja Pyjore, zyrat e ish Komunave aktualisht Njësi Administrative. Vlera e trojeve të cilat me VKM janë kaluar në pronësi të Bashkisë Fushë Arrëz. Pra vlera e trojeve të objekteve pasi të ishte vlerësuar me komision të ngritur nga titullari i institucionit duhej të pasqyrohej në këtë llogari.

-Llogaria aktive e Pasqyrave Financiare nr.211 “Pyje, kullota, plantacione” paraqitet në vlerën 4,680,802 lekë, e cila përfaqëson vlerën e pyllëzimeve me Arrë, Gështenjë dhe Akacie të bërë në Bashkinë Fushë Arrëz dhe Njësitë Administrative, në vitet e mëparshme. -Në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera e 394 pronave me sipërfaqe 65,287,847 m² Pyje e Kullota, të cilat janë regjistruar në ZVRPP Pukë, të evidentuara nga zyra e pyjeve e kullotave të bashkisë. Këto prona janë regjistruar në vitet 2012-2013 nga ish-bashkia Fushë Arrëz dhe ish-Komuna Qaf Mali, pajisur me Certifikatë pronësie. Pra vlera e këtyre pronave pasi të ishte vlerësuar me komision të ngritur nga titullari i institucionit duhej të pasqyrohej në këtë llogari.

-Në Bashkinë Fushë-Arrëz, Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen jo plotësisht. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm;

-**Nga auditimi mbi përputhshmërinë⁴** e procedurave të prokurimit publik, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti Bashkia Fushë-Arrëz, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), bazuar në ISSAI 4000 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, “Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë”, shprehemi **për opinion të kualifikuar/me rezervë** pasi u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura, të cilat konsistojnë:

- Shkelje të kuadrit rregullator në fuqi në fushën e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, lidhur me kriteret e vendosura në DST nga ku rezultoi se nuk kanë gjetur zbatim aktet ligjore e nënligjore të fushës së prokurimit publik, duke mos i argumentuar këto kërkesa në lidhje të ngushtë me objektin e kontratës, veprim në kundërshtim me nenin 26, pika 5, nenin 61, pika 2, paragraf i të VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për arsye të skualifikimit të operatorëve ekonomikë si pasojë e kriterëve të vendosura në DST dhe devijimeve të vogla të parashikuara në ligj dhe OE të shpallur fitues edhe pse në kushtet e

⁴ Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH-së”.

mosplotësimit të DST, pa ekonomikitet, eficence dhe efektivitet në vlerën 129,524,481 lekë dhe konkretisht:

-“Rikonstruksion i Shkollës, së Mesme 70 Vjetori i Pavarësisë, në Fushë-Arrëz, për vlerën e kontraktuar prej 57,040,969 lekë.

-“Sistemim asfaltim i rrugëve të fshatit Fushë-Arrëz (lagjia Fushaxhi)”, për vlerën e kontraktuar prej 47,050,191 lekë.

-“Rikonstruksion i Shkollës, 9-vjeçare Iballë, Njësia Administrative Iballë”, për vlerën e kontraktuar prej 18,025,572 lekë.

-“Mirëmbajtje e rrugëve auto rurale për vitin 2017 në Bashkinë Fushë-Arrëz”, për vlerën e kontraktuar prej 4,996,685 lekë

-“Mirëmbajtje kanalesh vaditëse në Bashkinë Fushë-Arrëz, viti 2018”, për vlerën e kontraktuar prej 1,251,973 lekë.

-“Mirëmbajtje në kanale dhe rezervuare për vaditje”, për vlerën e kontraktuar prej 1,159,091 lekë.

- Në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve, në 3 raste u konstatuan shkelje për volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt, të cilat kanë shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të njësisë vendore në vlerën totale 1,665,690 lekë dhe konkretisht për objektet:

-“Rikonstruksioni i fasadave dhe sheshit të qytetit Fushë Arrëz”, për vlerën prej 1,068,475 lekë

-“Sistemim Asfaltim i rrugëve të fshatit Fushë-Arrëz (Lagjia Fushaxhi)”, për vlerën prej 301,640 lekë.

-“Ndërtim i rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm dhe restaurimit të depove ekzistuese në Bashkinë Fushë-Arrëz”, për vlerën prej 295,575 lekë.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga subjekti i audituar njësia e VQV Bashkia Fushë-Arrëz, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Fushë-Arrëz

Drejtimi i Bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Staf i drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Staf i drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomalitë materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur

kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

B. MASA ORGANIZATIVE:

1.Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura rezulton se më datën 31.12.2018 Bashkia Fushë Arrëz ka detyrime të papaguara ndaj të tretëve në vlerën **10,849,996 lekë**, të cilat janë pasqyruar në kontabilitet, në llogarinë nr.401-408, furnitor e llogari të lidhura me to, prej tyre 6 subjekte kreditore në vlerën 3,288,264 lekë dhe 6 persona të cilët kanë fituar vendimet e gjykatave në vite të cilat kanë marrë formën e prerë për vlerën **7,561,732 lekë**. Veprimet apo mos veprimet janë në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne R.SH”, ndryshuar me ligjin nr. 114/2012/datë 07.12.2012 dhe ligjin nr.57/2016, datë 2.6.2016), Neni 40 ⁽⁵⁾-E drejta për të kryer shpenzime,

-UMF nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr.5/1 datë 21.05.2014.

-Udhëzimin plotësues të MF nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”,

-UMF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore” (Më hollësisht trajtuar në pikën B. faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Bashkia Fushë Arrëz, Sektori i Financës, bazuar në Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe Udhëzimin plotësues të MF nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe pikat 116-117- *Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore*”, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën **10,849,996 lekë**, sipas Aneksit bashkangjitur mbi gjendjen e faturave të palikujduara me datën 31.12.2018, e rakorduar kjo me pasqyrën e dërguar në Ministrinë e financave.

Në mbledhjen me të afërt të Këshillit Bashkiak

2. Gjetje nga auditimi: Programimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, për vitin 2017, është miratuar në vlerën 21,000 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 20,991 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 8,4 mijë lekë, ose 99,9%. Për vitin 2018, programimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, është miratuar në vlerën 26,000 mijë lekë, realizuar në fakt në vlerën 20,952 mijë lekë me mosrealizim në vlerën 5,047 mijë lekë, ose 80,5%. Detyrimet debitorë të taksave për bizneset gjendje me 31.12.2017 janë në vlerën 13,299 mijë lekë nga 109 subjekte, me 31.12.2018 janë në vlerën 22,528 mijë lekë nga 118 subjekte. Debitorët për taksat dhe tarifatat vendore familjare nuk është dokumentuar nga zyra e taksave dhe tarifave vendore, për 670 familje të cilat kanë detyrimin për të paguar taksa dhe tarifa vendore. Realizimi i të ardhurave është në nivele shumë të ulët për vitin 2018, ku ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga taksat lokale ka mos realizimi i të ardhurave nga taksa mbi pasurinë, e cila është programuar në masën 9,408 mijë lekë, realizuar në masën 5,042 mijë lekë ose 54% si dhe mos realizimi i të ardhurave nga tarifatat lokale, si tarifa e parkingut me 24% , tarifa e zënies së hapësirave publike, realizuar me 29% dhe të ardhurat nga shitja e druve të zjarrit është realizuar në masën prej 20,4 % (Më hollësisht trajtuar në pikën B. faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

⁵⁾ Ndryshuar me ligjin nr. 57/2016.

2.1. Rekomandimi: Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Fushë Arrëz, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, të marrë masat për arkëtimin e detyrimeve tatimore duke bërë njoftim vlerësimet tatimore:

-për 118 subjekte të biznesit të madh e të vogël, debitorë ***në shumën 22,528,000 lekë*** dhe për 670 familje debitore për taksa dhe tarifa vendore.

Duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a- Tu dërgohen bankave (subjekteve që nuk u është dërguar) urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

b- Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

c- Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 %, kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative për dënimin me gjobë deri në kallëzim penal.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e pasqyrave financiare për periudhën 01 janar deri 31 dhjetor viti 2018, konstatohet se:

Në llogaritë e poshtëshënuara të AQT, ka pasaktësi në paraqitjen e pozicionit financiar në pasqyrat financiare e konkretisht:

a-Në llogarinë 31 “Materiale”, është regjistruar gabim vlera prej 85,530 lekë, pasi kjo vlerë duhet të regjistrohej në llogarinë 32 “Inventar i imët”. në kundërshtim me kërkesat e ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare“ dhe VKM nr.783,datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”, kapitulli III “Gjendjet e inventarit dhe të prodhimit në proces” seksioni I “Përbërja, klasifikimi kontabël dhe mënyrat e ndjekjes në kontabilitet”, pika 1 “Përbërja dhe klasifikimi kontabël” (*Më hollësisht trajtuar në pikën B. faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

b-Në llogarinë 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” nuk pasqyrohet vlera e saktë, për arsye se vlera prej 6,613,000 lekë i përkasin investimeve për objekte të përfunduara në vitet e kaluar e cila, duhej të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit, në kundërshtim me kërkesat e ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare“ dhe UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b” (*Më hollësisht trajtuar në pikën C. faqe 51-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

c-Në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene”, nuk është pasqyruar, vlera e trojeve të ndërtesave të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione” dhe vlera e trojeve të cilat me Vendime të Këshillit të Ministrave janë kaluar në pronësi të Bashkisë Fushë Arrëz. në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Neni 7, pika 1 dhe 2; UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV. pika 74 dhe 96, (*Më hollësisht trajtuar në pikën C. faqe 51-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

d-Në llogarinë 211 “Pyje, kullota, plantacione” nuk pasqyrohet vlera e 394 pronave me sipërfaqe 65,287,847 m² Pyje e Kullota, të cilat janë regjistruar në ZVRPP Pukë, pra vlera e këtyre pronave pasi të ishte vlerësuar me komision të ngritur nga titullari i institucionit duhej të pasqyrohej në këtë llogari. në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” Neni 7, pika 1 dhe 2; UMF nr. 30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV. pika 74 dhe 96 (*Më hollësisht trajtuar në pikën C. faqe 51-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Bashkia Fushë Arrëz, Drejtoria e Financës, të marrë masa për të zbatuar procedurat ligjore për të kryer sistemimin e veprimeve:

a. Të llogarisë 31 “Materiale” dhe të llogarisë nr.32 “Objekte inventari” të gjendjeve të inventarit qarkullues, për vlerën 85,530 lekë.

b. Të llogarisë 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” duke bërë që në këtë llogari të paraqitet vetëm vlera e projekteve, për të cilat investimet nuk kanë përfunduar, kurse vlera prej 6,613,000 lekë i përkasin investimeve për objekte të përfunduara në vitet e kaluar e cila, duhet sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit.

c. Të llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” duke bërë që në këtë llogari të paraqitet, vlera e trojeve të ndërtesave të pasqyruar në llogarinë 212 “Ndërtime e konstruksione”, vlera e trojeve të cilat me VKM janë kaluar në pronësi të Bashkisë si dhe të kryhet inventarizimi i trojeve me komision.

d. Të llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, për vlerën e 394 pronave me sipërfaqe 65,287,847 m² Pyje e Kullota, të cilat janë regjistruar në ZVRPP Pukë, pasi të bëhet vlerësimi me komision të ngritur nga titullari i institucionit.

Në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2019

4. Gjetje nga auditimi: Plani Strategjik edhe pse është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2017 – 2019, por ai nuk është përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6, sepse mungon pjesa përshkuese e këtij plani.

- Planifikimet vjetore të auditimeve për vitin 2017, dhe 2018 edhe pse janë përgatitur rregullisht, ata nuk janë përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2, sepse mungon pjesa përshkuese e këtij planifikimi (*Më hollësisht trajtuar në pikën B. faqe 51-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Plani strategjik, planifikimi vjetor, si dhe gjithë dokumentacioni tjetër i nevojshëm në procesin auditues të NjAB, të përpilohen në përputhje me MAB.

Në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nuk janë çelur dosjet e përhershme për çdo njësi publike të audituar, për ti shërbyer auditimit pasardhës, veprim që bie në kundërshtim me MAB, Kapitulli nr. VI, pika 6.3.

Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike janë mbajtur e plotësuar në përputhje me kërkesat e MAB, por administrimi i tyre nuk është bërë në përputhje me ligjin 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, sepse ato nuk janë arkivuar në zyrë-arkivin e njësisë (*Më hollësisht trajtuar në pikën B. faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Nga NjAB të çelen dosjet e përhershme për çdo subjekt të audituar, duke i pasuruar ato me materiale nga auditimet e reja, me qëllim që kjo ti shërbej auditimeve pasardhëse të këtij subjekti.

Nga NjAB pas përfundimit të auditimit të brendshëm të subjekteve publike, të kryhet inventarizimi i dosjes koherente për çdo auditim, dhe të arkivohen ato në zyrë arkivin e bashkisë Fushë Arrëz, në përputhje me ligjin 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Brenda vitit 2019

6. Gjetje nga auditimi: Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” pika 40, dhe ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 4 pika 19 “Gjurma e auditimit” dhe neni 16 pika 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën B. faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Titullari i njësisë publike, vet ose nëpërmjet personit autorizues, të marrë masa për miratimin e gjurmëve të auditimit në zbatim të UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” pika 40, dhe ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 4 pika 19, dhe neni 16 pika 2.

Në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në këtë Njësi të Qeverisjes Vendore, nuk aplikohen programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar. Sistemi kompjuterik nuk është i certifikuar nga kompani e licencuara për ruajtjen e të dhënave, pasi sistemi kompjuterik nuk mbron asetet dhe nuk ruan integritetin e të dhënave. Veprim që bie në kundërshtim me ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik” (*Më hollësisht trajtuar në pikën B. faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Njësia publike të marrë masa, të certifikoj sistemin kompjuterik nga kompani të licencuara për ruajtjen e të dhënave, të mbroj sistemin kompjuterik dhe asetet duke ruajtur integritetin e të dhënave, financiar dhe çdo informacion origjinal, plotësues dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitet publike.

Në vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimi: GMS, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjikë me afat jo më pak se sa 5 vjet, kërkesë e ligjit nr. 68/2017 ”Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 32 dhe UMF Plotësues nr. 8 datë 29.3.2012 “Procedurat e përgatitjes të Buxhetit afatmesëm”, Kap. V (*Më hollësisht trajtuar në pikën B. faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Nga Grupi Menaxhimit Strategjik, të hartohet e miratohet Plani Strategjik në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 68/2017 ”Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 32 dhe UMF Plotësues nr 8 dt. 29.3.2012 “Procedurat e përgatitjes të Buxhetit afatmesëm”, Kap. V.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Struktura e raportit për funksionimin e SKB për vitet 2017, dhe 2018, nuk është në përputhje me shtojcën nr 2, të Udhëzimit nr. 28, datë 15.12.2011(*Më hollësisht trajtuar në pikën B. faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandimi: Nga struktura përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësi të merren masa që dokumentacioni të përgatitet në përputhje me kuadrin ligjor.

Në vazhdimësi

10. Gjetje nga auditimi: Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar **19** masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht **19** masa, nga të pranuarat janë zbatuar **2** masa dhe është në proces zbatimi **1** masa organizative, ndërkohë që **16** masa organizative nuk janë zbatuar.

Për shpërblim dëmi janë rekomanduar **29** masa me vlerë **234,293,708** lekë, është pranuar dhe kontabilizuar e gjithë vlera dhe deri me datë 31.12.2018, janë arkëtuar **780,637** lekë, ndërsa shuma **233,513,071** lekë nuk është arkëtuar. Prej masave të rekomanduar **2** masa janë zbatuar, **10** masa janë zbatuar pjesërisht, dhe **17** masa nuk janë zbatuar.

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej 234,293,708 lekë

-Deri më datën 31.12.2018 është arkëtuar 780,637 lekë

Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej..... 233,513,071 lekë

Nga të cilat:

-Në proces arkëtimi rekomandim në vlerën.....908,409 lekë

-Janë nisur njoftimet për 117 rekomandime me vlerë 908,409 por ende nuk kanë filluar arkëtimet për 96 rekomandime me vlerë 232,594,011 lekë.

Vlera e debitorëve në bilancin e audituar ka qenë **233,992,561** lekë për vitin 2017. Për vitin 2018 vlera e debitorëve është bërë **233,513,071** lekë. Shuma e debitorëve të dala nga auditimi i KLSH-së në vlerë **234,293,708** lekë është kontabilizuar në llogarinë 468 në vitin 2017. Nga këto janë arkëtuar **780,637** lekë dhe gjendja e debitorëve më 31.12.2018 është në total për shumën **233,513,071** lekë.

Gjetje: nga KLSH-ja i është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara për **2** persona. Nga verifikimi rezultoi se Bashkia Fushë Arrëz meqenëse nuk kishte IMTV, i është drejtuar për kompetencë me shkresë me nr. 2127 prot. datë 06.09.2017 IKMT-ës, por prej këtij të fundit ka ardhur përgjigje refuzuese për procedurën me shkresën nr.

3413/1, datë 19.09.2017, duke argumentuar se kjo procedurë është kompetencë e IMTV Bashkia Fushë Arrëz. Aktualisht rezulton që rekomandimi nuk është zbatuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën E. faqe 145-146 dhe 199-230 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, të marrë në analizë situatën e zbatimit të shkresës nr. 414/7, datë 21.07.2016 “Për zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH në auditimin e mëparshëm”, të dalin përgjegjësitë individuale dhe institucionale për mos vlerësim dhe zbatim të masave të rekomanduara nga KLSH, si dhe të hartohet plan-veprimi specifik për vlerësimin sipas afateve administrative për zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH me shkresë nr. 414/7, datë 21.07.2016.

Menjëherë

11-Gjetje nga auditimi: Bashkia Fushë-Arrëz edhe pse ka mazhorancën e aksioneve në Ujësjetllës sh.a Fushë-Arrëz dhe për vitet 2017-2018, ka në Këshillin e Administrimit 1, punonjës nuk ka mundur realizimin e lidhjes së një marrëveshje, në të cilën Ujësjetllësi sh.a. Fushë-Arrëz të përcaktohej si agjent tatimor për arkëtimin e taksave vendore së bashku me faturat e ujit të pijshëm, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5 shkronja (ii), neni 7, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, pikës 7.1 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore”, marrëveshje e cila do të rriste arkëtimin e taksave vendore dhe do rigjenerojë të ardhura për Bashkinë Fushë-Arrëz (*Trajtuar në faqen 38-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: Bashkia Fushë-Arrëz ti kërkojë Këshillit Bashkiak në bazë të një aktmarrëveshje të përcaktohet Ujësjetllësi sh.a. Fushë-Arrëz, si agjent tatimor për arkëtimin e taksave vendore së bashku me faturat e ujit të pijshëm, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5 shkronja (ii), neni 7, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, pikës 7.1 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, marrëveshje e cila do të rriste arkëtimin e taksave vendore dhe do rigjenerojë të ardhura për Bashkinë Fushë-Arrëz.

Menjëherë

12. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak (pas konstituimit) të analizojë Raportin Përfundimtar të Auditimit të kryer **në Bashkinë Fushë-Arrëz** për periudhën e veprimtarisë ekonomike 01.01.2017-31.12.2018, duke analizuar të gjitha shkeljet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, nenit 50-Auditimi i jashtëm pika 4 dhe 5 ku përcaktohet se; Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij.

Në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer për planifikimin, realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, konstatohet se nga Bashkia Fushë Arrëz, Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk është vepruar, për të lidhur kontratë qiraje me subjektin “OST” sha, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore ku ushtron aktivitetin për qëllime biznesi, për ndërtimin e linjës ajrore të interkonjeksionit 400 kv Shqipëri-Kosovë, miratuar në KKT me vendimin nr.2, datë 03.12.2014, rishikuar me vendimin nr.4, datë 17.02.2006, objekti shtrihet në

territorin e Bashkisë Fushë Arrëz në një gjatësi prej 20,85 km x 60,000 lekë/km/vit, detyrimi vjetor përlllogaritur është 1,251,000 lekë x 2 vjet, rezulton se veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në VKM nr 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr.2, pikat 15, me pasojë, **të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz në vlerën 2,502,000 lekë** (Më hollësisht trajtuar në pikën B. faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Bashkia Fushë Arrëz, që t’i kërkojë shoqërisë “OST” sha, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **2,502,000 lekë**, detyrim qira për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore e kullimore.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Shkollës, së Mesme 70 Vjetori i Pavarësisë, në Fushë-Arrëz”, me vlerë prej **57,189,910 lekë**, me BOE të shpallur fitues “**V.N.IS**” dhe “**N.**” shpk, për vlerën e kontraktuar prej 57,040,969 lekë”, ose më pak se fondi limit për shumën 148,941 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 2 OE, është shpallur fituese OE i cili nuk plotësonte kriteret e veçantë, të DST. Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE “**V.N.IS**” dhe “**N.**” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, efencë dhe efektivitet, në vlerën **57,040,969 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën D. faqe 67-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **57,040,969 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çënojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Shkollës 9-vjeçare Iballë, Njësia Administrative Iballë”, me vlerë prej **18,131,244 lekë**, me BOE të shpallur fitues “**V.N.IS**” dhe “**N.**” shpk, për vlerën e kontraktuar prej 18,025,572 lekë”, ose më pak se fondi limit për shumën 129,351 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 2 OE, është shpallur fituese OE i cili nuk plotësonte kriteret e veçantë, të DST. Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE “**V.N.IS dhe N.**” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, efencë dhe efektivitet, në vlerën **18,025,572 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshua (Më hollësisht trajtuar në pikën D. faqe 67-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **18,025,572 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çënojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugëve të fshatit Fushë-Arrëz (lagjia Fushaxhi)”, me vlerë prej **47,059,071 lekë**, me BOE të shpallur fitues “**R. 2008**” & “**K.**” shpk, për vlerën e kontraktuar prej 47,050,191 lekë”, ose më pak se fondi

limit për shumën 8,880 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 2 OE, është shpallur fituese OE i cili nuk plotësonte kriteret e veçantë, të DST. Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE “**R. 2008**” & “**K.**” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën **47,050,191 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën D. faqe 67-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **47,050,191 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çënojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje e rrugëve auto rurale për vitin 2017 në Bashkinë Fushë-Arrëz”, me vlerë prej **5,279,945 lekë**, me OE të shpallur fitues “**P. G.**” shpk, për vlerën e kontraktuar prej 4,996,895 lekë”, ose më pak se fondi limit për shumën 283,260 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se ka marrë pjesë vetëm OE, i cili është shpallur fitues, OE i cili nuk plotësonte kriteret e veçantë, të DST. Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE “**P. G.**” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën **4,996,895 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën D. faqe 67-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **4,996,895 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çënojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje kanalesh vaditëse në Bashkinë Fushë-Arrëz, viti 2018”, me vlerë prej **1,460,833 lekë**, me BOE të shpallur fitues “**A.**” & “**D. I.**” shpk, për vlerën e kontraktuar prej 1,251,973 lekë”, ose më pak se fondi limit për shumën 208,860 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se ka marrë pjesë vetëm BOE, i cili është shpallur fitues, OE i cili nuk plotësonte kriteret e veçantë, të DST. Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE “**A.**” & “**D. I.**” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën **1,251,973 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën D. faqe 67-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **1,251,973 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çënojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje në kanale dhe rezervuare për vaditje”, me vlerë prej **1,338,209 lekë**, me OE të shpallur fitues “A.” shpk, për vlerën e kontraktuar prej 1,159,091 lekë”, ose më pak se fondi limit për shumën 179,118 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se ka marrë pjesë vetëm OE, i cili është shpallur fitues, OE i cili nuk plotësonte kriteret e veçantë, të DST. Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE “A.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën **1,159,091 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën D. faqe 67-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **1,159,091 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Menjëherë

D. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i Njësisë Publike Bashkia Fushë-Arrëz, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,665,690 lekë**, si më poshtë:*

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Rikonstruksioni i fasadave dhe sheshit të qytetit Fushë Arrëz*”, *Bashkia Fushë Arrëz*, me vlerë të kontratës (me tvsh) 88,836,310 lekë, fituar nga BOE “E.” & “K. K.” shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 1,068,475 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 97 prot datë 20.01.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Fushë Arrëz dhe “E.” & “K. K.” Shpk (*trajtuar më hollësisht në faqet 118-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Fushë Arrëz të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,068,475 lekë pa tvsh** nga BOE “E.” & “K. K.” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 97 prot datë 20.01.2017, me objekt “Rikonstruksioni i fasadave dhe sheshit të qytetit Fushë Arrëz”, Bashkia Fushë Arrëz, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Fushë-Arrëz, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit (*Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve*).

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “*Sistemim Asfaltim i rrugëve të fshatit Fushë-Arrëz (Lagjia Fushaxhi)*”, *Bashkia Fushë-Arrëz*, me vlerë të kontratës 56,460,229.20 lekë me TVSH, fituar nga BOE “C. R. 2008” & “K.”

shpk, përfaqësuar nga OE “C. R. 2008” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **301,640 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1853 prot, datë 31.07.2017, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Fush-Arrëz dhe përfaqësuesit OE “C. R. 2008” shpk (*trajtuar më hollësisht në faqet 118-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Fushë Arrëz të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **301,640 lekë pa tvsh** nga OE “C. R. 2008” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1853 prot datë 31.07.2017, me objekt **“Sistemim Asfaltim i rrugëve të fshatit Fush-Arrëz (Lagjia Fushaxhi)”**, Bashkia Fush-Arrëz, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Fush-Arrëz, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit (*Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve*).

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Ndërtim i rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm dhe restaurimit të depove ekzistuese në Bashkinë Fushë-Arrëz”**, me vlerë të kontratës 74,091,112.8 lekë me TVSH, fituar nga OE **“J.”** shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **295,575 lekë pa tvsh** për punime të pakryera. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 103 prot, datë 20.01.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Fushë-Arrëz dhe OE **“J.”** shpk (*trajtuar më hollësisht në faqet 118-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandim: Të merren masa nga Bashkia Fushë Arrëz, që t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve OE **“J.”** SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma prej **295,575 lekë pa TVSH** të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë së defekteve (16.08.2019). Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Fushë-Arrëz, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit (*Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve*).

Menjëherë

E. MASA ADMINISTRATIVE:

E/I. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe vërejtjeve, komenteve dhe dokumentacionit shoqëruar të paraqitura nga subjekti i audituar, mbështetur në nenet 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo duke ja deleguar këtë kompetencë autoritetit kontraktor, për 7 (shtatë) punonjës dhe ish-punonjës, si më poshtë:**

1. z. F. T., me detyrë Kryetar i Bashkisë.

Për shkeljet e kryera në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor në 6 (gjashtë) procedurat e mëposhtme:

-“Rikonstruksion i Shkollës, së Mesme 70 Vjetori i Pavarësisë, në Fushë-Arrëz, për vlerën e kontraktuar prej 57,040,969 lekë.

-“Sistemim asfaltim i rrugëve të fshatit Fushë-Arrëz (lagjia Fushaxhi)”, për vlerën e kontraktuar prej 47,050,191 lekë.

-“Rikonstruksion i Shkollës, 9-vjeçare Iballë, Njësia Administrative Iballë”, për vlerën e kontraktuar prej 18,025,572 lekë.

-“Mirëmbajtje e rrugëve auto rurale për vitin 2017 në Bashkinë Fushë-Arrëz”, për vlerën e kontraktuar prej 4,996,685 lekë

-“Mirëmbajtje kanalesh vaditëse në Bashkinë Fushë-Arrëz, viti 2018”, për vlerën e kontraktuar prej 1,251,973 lekë.

-“Blerje automjeti dhe pajisje zjarrëfikëse”, për vlerën e kontraktuar prej 3,333,325 lekë.

2. z. K. S., me detyrë Nënkrjetar i Bashkisë, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

3. z. A. D., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Pyjor, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

4. z. F. D., me detyrë Specialist Ekonomist, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,

në 6 (gjashtë) procedurat e mëposhtme:

-“Rikonstruksion i Shkollës, së Mesme 70 Vjetori i Pavarësisë, në Fushë-Arrëz, për vlerën e kontraktuar prej 57,040,969 lekë.

-“Sistemim asfaltim i rrugëve të fshatit Fushë-Arrëz (lagjia Fushaxhi)”, për vlerën e kontraktuar prej 47,050,191 lekë.

-“Rikonstruksion i Shkollës, 9-vjeçare Iballë, Njësia Administrative Iballë”, për vlerën e kontraktuar prej 18,025,572 lekë.

-“Mirëmbajtje e rrugëve auto rurale për vitin 2017 në Bashkinë Fushë-Arrëz”, për vlerën e kontraktuar prej 4,996,685 lekë

-“Blerje automjeti dhe pajisje zjarrëfikëse”, për vlerën e kontraktuar prej 3,333,325 lekë.

-“Mirëmbajtje kanalesh vaditëse në Bashkinë Fushë-Arrëz, viti 2018”, për vlerën e kontraktuar prej 1,251,973 lekë.

5. zj. L. Gj., me detyrë Specialiste Juriste e çështjeve juridike dhe prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të Njesisë të hartimit të dokumenteve të tenderit,

6. z. T. P., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të Njesisë të hartimit të dokumenteve të tenderit,

7. zj. E. M., me detyrë Përgjegjës i Tatim Taksave, në cilësinë e anëtarit të Njesisë të hartimit të dokumenteve të tenderit, **në 6 (gjashtë) procedurat e mëposhtme:**

-“Rikonstruksion i Shkollës, së Mesme 70 Vjetori i Pavarësisë, në Fushë-Arrëz, për vlerën e kontraktuar prej 57,040,969 lekë.

-“Sistemim asfaltim i rrugëve të fshatit Fushë-Arrëz (lagjia Fushaxhi)”, për vlerën e kontraktuar prej 47,050,191 lekë.

-“Rikonstruksion i Shkollës 9-vjeçare Fierzë, Njësia Administrative Fierzë”, për vlerën e kontraktuar prej 27,534,895 lekë.

-“Rikonstruksion i Shkollës, 9-vjeçare Iballë, Njësia Administrative Iballë”, për vlerën e kontraktuar prej 18,025,572 lekë.

-“Mirëmbajtje e rrugëve auto rurale për vitin 2017 në Bashkinë Fushë-Arrëz”, për vlerën e kontraktuar prej 4,996,685 lekë

-“Blerje automjeti dhe pajisje zjarrëfikëse”, për vlerën e kontraktuar prej 3,333,325 lekë.

Në 6 procedura prokurimi, nga ana e KVO si rezultat i kualifikimit dhe shpalljes fitues të OE apo BOE me mangësi në dokumentacion, ka sjellë pasoja me efekte negative në administrimin e

fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike.

Më konkretisht për:

- Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Shkollës, së Mesme 70 Vjetori i Pavarësisë, në Fushë-Arrëz”, me vlerë prej **57,189,910 lekë**, me BOE të shpallur fitues **“V.N.IS” dhe “N.”** shpk, për vlerën e kontraktuar prej 57,040,969 lekë”, ose më pak se fondi limit për shumën 148,941 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 2 OE, është shpallur fituese OE i cili nuk plotësonte kriteret e veçantë, të DST. Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE **“V.N.IS dhe N.”** shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet, në vlerën **57,040,969 lekë**.

-Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Shkollës 9-vjeçare Iballë, Njësia Administrative Iballë”, me vlerë prej **18,131,244 lekë**, me BOE të shpallur fitues **“V.N.IS” dhe “N.”** shpk, për vlerën e kontraktuar prej 18,025,572 lekë”, ose më pak se fondi limit për shumën 129,351 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 2 OE, është shpallur fituese OE i cili nuk plotësonte kriteret e veçantë, të DST. Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE **“V. N. IS” dhe “N.”** shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet, në vlerën **18,025,572 lekë**.

- Në procedurën e prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugëve të fshatit Fushë-Arrëz (lagjia Fushaxhi)”, me vlerë prej **47,059,071 lekë**, me BOE të shpallur fitues **“R. 2008” & “K.”** shpk, për vlerën e kontraktuar prej 47,050,191 lekë”, ose më pak se fondi limit për shumën 8,880 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 2 OE, është shpallur fituese OE i cili nuk plotësonte kriteret e veçantë, të DST. Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE **“R. 2008” & “K.”** shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet, në vlerën **47,050,191 lekë**.

- Në procedurën e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje e rrugëve auto rurale për vitin 2017 në Bashkinë Fushë-Arrëz”, me vlerë prej **5,279,945 lekë**, me OE të shpallur fitues **“P. G.”** shpk, për vlerën e kontraktuar prej 4,996,895 lekë”, ose më pak se fondi limit për shumën 283,260 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se ka marrë pjesë vetëm OE, i cili është shpallur fitues, OE i cili nuk plotësonte kriteret e veçantë, të DST. Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE **“P. G.”** shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet, në vlerën **4,996,895 lekë**.

-Në procedurën e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje kanalesh vaditëse në Bashkinë Fushë-Arrëz, viti 2018”, me vlerë prej **1,460,833 lekë**, me BOE të shpallur fitues **“A.” & “D. I.”** shpk, për vlerën e kontraktuar prej 1,251,973 lekë”, ose më pak se fondi limit për shumën 208,860 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se ka marrë pjesë vetëm BOE, i cili është shpallur fitues, OE i cili nuk plotësonte kriteret e veçantë, të DST. Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE **“A.” & “D. I.”** shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet, në vlerën **1,251,973 lekë**.

- Në procedurën e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje në kanale dhe rezervuare për vaditje”, me vlerë prej **1,338,209 lekë**, me OE të shpallur fitues **“A.”** shpk, për vlerën e kontraktuar prej 1,159,091 lekë”, ose më pak se fondi limit për shumën 179,118 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se ka marrë pjesë vetëm OE, i cili është shpallur fitues, OE i cili nuk plotësonte kriteret e veçantë, të DST. Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE **“A.”** shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet, në vlerën **1,159,091 lekë**.

Veprime në papajtueshmëri me nenet 24, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 67-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJP, në hartimin e kriterëve të kualifikimit, NJP nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së kriterëve, siç kërkohet shprehimisht nga neni 61 i VKM-së nr.

914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, gjithashtu disa nga kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim me llojin e punës së kërkuar duke mos u argumentuar teknikisht dhe ligjërish vendosja dhe miratimi i tyre (trajtuar më hollësisht në faqet 67-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

E/II. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe konstatimeve të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe vërejtjeve, komenteve dhe dokumentacionit shoqërues të paraqitura nga subjekti i audituar, *mbështetur në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”* dhe bazuar në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 13, pika 3, shkronja “ç”, si dhe në VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 77, pika 2, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljen e konstatuara, fillimin e procedimit administrativ, duke vendosur për përjashtimin e operatorit ekonomik “V.N.I.S.” shpk, nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, për sa më poshtë:**

-Në procedurën e “Hapur” të prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Shkollës, 9-vjeçare Iballë, Njësia Administrative Iballë”, me vlerë të fondit limit 18,131,244 lekë pa tvsh, procedurë për të cilën është shpallur fitues BOE “V.N.I.S” dhe “N.” shpk, për vlerën prej 18,025,572 lekë, me diferencë nga fondi limit prej 105,672 lekë, OE “V.N.I.S” shpk, ka rezultuar se ndodhet në kushtet e keqinformimit për qëllime kualifikimi duke paraqitur dokumente të rreme apo pa vërteta.

-Në procedurën e “Hapur” të prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Shkollës së Mesme 70 Vjetori i Pavarësisë në Fushë-Arrëz”, me vlerë të fondit limit 57,189,910 lekë pa tvsh, procedurë për të cilën është shpallur fitues BOE “V.N.I.S” dhe “N.” shpk, për vlerën prej 57,040,969 lekë, me diferencë nga fondi limit prej 148,981 lekë, OE “V.N.I.S” shpk, ka rezultuar se ndodhet në kushtet e keqinformimit për qëllime kualifikimi duke paraqitur dokumente të rreme apo pa vërteta.

Përshkrimi i shkakut për përjashtim nga prokurimet të OE

Lidhur mbi disponueshmërinë e certifikatës ISO 28000:2007, “Ndërtimin dhe rinovimin e ndërtimeve civile dhe industriale, infrastrukturës rrugore, autostrada, mbikalime, hekurudha, punime nëntokësore, ura e vepra arti, punime në diga, hidrocentrale, sisteme të ujësjellësve dhe ujërave të zeza. Mirëmbajtje rrugësh rutine dhe ndërtesash civile dhe industriale”.

Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistem SEP, rezulton se të dy operatorët ekonomik “N.” shpk dhe “V.N.I.S” shpk disponojnë certifikatën ISO 28000:2007 “Certificate of conformity” për “Ndërtim dhe rinovim i ndërtimeve civile dhe industriale, infrastrukturë rrugore, autostrada, mbikalime, hekurudha, punime nëntokësore, ura e vepra arti, punime në diga, hidrocentrale, sisteme të ujësjellësve dhe ujërave të zeza. Mirëmbajtje rrugësh rutinë dhe ndërtesash civile dhe industrial”.

Nga verifikimi on-line në faqen zyrtare të kompanisë certifikuese AQSCERT (Certifications & Inspections body) www.aqscert.org, në rubrikën “Certifikatat e mia” rezulton se OE “N.” shpk, disponon certifikatën ISO 28000:2007 me nr. AQS/SSC/15272017, me të dhënat e poshtëshënuara, të cilat rezultojnë të njëjta me atë të ngarkuar në sistem nga ky operator.

Emri i Kompanisë: “N.” Sh.p.k. NIPT: K...I

Adresa: Rruga ..., Njesia Bashkiake Nr. 8, Tirane, Albania

Nr. i Certifikatës.: AQS/SSC/15272017

Standarti: ISO 28001:2007

Fusha EN: Construction and renovation of civil and industrial constructions, road infrastructure, highways, overpasses, railways, underground works, bridges, works of art, works on the dams, hydropower, water supply systems and sewerage. Routine maintenance of road and civil and industrial building.

Fusha AL: Ndërtim dhe rinovim i ndërtimeve civile dhe industriale, infrastrukturë rrugore, autostrada, mbikalime, hekurudha, punime nëntokësore, ura e vepra arti, punime në diga, hidrocentrale, sistemeve të ujësjellësve dhe ujërave të zeza. Mirëmbajtje rrugësh rutinë dhe ndërtesash civile dhe industriale.

First Issue Date: 13/02/2017

Data e Modifikimit: 08/02/2019

Vlefshmëria: Valid

Data e Skadencës: 12/2/2020

Lidhur me OE "V.N.I.S" shpk po nga verifikimi on-line në faqen zyrtare të kompanisë certifikuese AQSCERT (Certifications & Inspections body) www.aqscert.org, në rubrikën "Certifikatat e mia" rezultojnë se OE "V.N.I.S" shpk, nuk disponon certifikatën ISO, edhe pse në SEP ky operator ka ngarkuar certifikatën ISO 28000:2007 me nr. AQS/PPS/16192017. Për këtë operator, pas plotësimit të rubrikave: Emri i kompanisë, AQS, Standarti dhe Certificate, dhe pas dhënies së komandës "Kërkim" rezultojnë se del shënimi se: **Certifikata nuk u gjet. Ju lutem kontaktoni info@aqscert.org.**

Sa më sipër rezultojnë se ky operator ekonomik nuk disponon certifikatën ISO 28000:2007 me nr. AQS/PPS/16192017. Në sistemin elektronik të prokurimeve por edhe në zyrën e protokoll arkivit të bashkisë, nuk rezultojnë të jetë bërë apo dokumentuar ndonjë kërkesë e Bashkisë dhe më saktësisht e KVO dhe Titullarit të AK, lidhur me vërtetësinë e këtij dokumenti të ngarkuar në sistem nga ky OE, pra nuk ka asnjë të dhënë se mbi çfarë bazë KVO ka vlerësuar përmbajtjen e këtij dokumenti përsa kohë nga kompania certifikuese për këtë subjekt dhe certifikatë, nuk gjenden informacion.

Për këtë kompani në sistem rezultojnë vetëm certifikata:

Emri i Kompanisë: "V.N. I.S" SHPK NIPT: K...Q

Adresa: Lagjia ...Diber, Albania

Nr. i Certifikatës.: AQS/SSC/19642017

Standarti: ISO 28001:2007

Fusha EN: Construction and renovation of civil and industrial constructions, road infrastructure, highways, overpasses, railways, underground works, bridges, works of art, works on the dams, hydropower, water supply systems and sewerage. Routine maintenance of road and civil and industrial building.

Fusha AL: Ndërtim dhe rinovim i ndërtimeve civile dhe industriale, infrastrukturë rrugore, autostrada, mbikalime, hekurudha, punime nëntokësore, ura e vepra arti, punime në diga, hidrocentrale, sistemeve të ujësjellësve dhe ujërave të zeza. Mirëmbajtje rrugësh rutinë dhe ndërtesash civile dhe industriale.

First Issue Date: 13/06/2017

Data e Modifikimit: 18/02/2019

Vlefshmëria: Valid

Data e Skadencës: 12/6/2020

Po ashtu nga verifikimi i lirë i të dy certifikatave të OE "N." shpk, i cili disponon certifikatën ISO 28000:2007 me nr. AQS/SSC/15272017 e cila rezultojnë dhe në sistemin e AQSCERT, si dhe Certifikatën e "V.N.I.S" shpk, e cila vetëm në SEP ka ngarkuar certifikatën ISO 28000:2007 me nr. AQS/PPS/16192017, certifikatë për të cilën AQSCERT në faqen zyrtare on-line nuk jep informacion duke dalë me shënimin "Certifikata nuk u gjet" rezultojnë se në të dy rastet

certifikatat e lëshuara kanë dy nënshkrime në fund të tyre njëri me shënimin “technical Direction” dhe tjetri “For certification body”, nënshkrime të cilat janë idem me njëra tjetrën, duke mos u kuptuar nëse janë nënshkrime elektronike ose jo (edhe pse në dokument nuk ka ndonjë rubrikë që sqaron formën e nënshkrimit të tyre nga personat përgjegjës).

Sa sipër, duke qenë se dokumentacioni i ngarkua në SEP nga OE “V.N.I.S.”, nuk rezulton në sistemin e AQSCERT dhe se paraqet të dhëna të njëjta me certifikatën ISO të OE tjetër pjesëmarrës në BOE “N.” shpk kërkojmë fillimin e procedimit administrativ, duke vendosur për përjashtimin e operatorit ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik.

KLSH bën me dije se, pavarësisht sa sipër do paraqesë Kallëzim Penal në Prokurori, për dokumentacionin e paraqitur nga subjekti.

Për Ministrinë Infrastrukturës dhe Energjisë.

Referuar parregullsive dhe shkeljeve të konstatuara, mbështetur në nenin **15 shkronjat (c dhe ç)** të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, VKM nr. 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit” nenin 13, nenin 25 dhe pika 1/a, 1/e, e nenit 41, Kreu VI-të, “Sanksione dhe dispozita kalimtare”, dhe Kreun VII-Sanksione, pikën 1,të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ndryshuar me VKM nr. 92 datë 19.02.2014, për shkelje të ligjshmërisë në zbatimin e punimeve, **i rekomandojmë** Komisionit të Licencave, **pranë Ministrisë e Infrastrukturës dhe Energjisë: “Heqjen e licencës profesionale”** operatorit ekonomik “V.N.I.S.” shpk, si më poshtë:

-Në procedurën e “Hapur” të prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Shkollës, 9-vjeçare Iballë, Njësia Administrative Iballë”, me vlerë të fondit limit 18,131,244 lekë pa tvsh, procedurë për të cilën është shpallur fitues BOE “V.N.I.S” dhe “N.” shpk, për vlerën prej 18,025,572 lekë, me diferencë nga fondi limit prej 105,672 lekë, OE “V.N.I.S” shpk, ka rezultuar se ndodhet në kushtet e keqinformimit për qëllime kualifikimi duke paraqitur dokumente të rreme apo pa vërteta.

-Në procedurën e “Hapur” të prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Shkollës së Mesme 70 Vjetori i Pavarësisë në Fushë-Arrëz”, me vlerë të fondit limit 57,189,910 lekë pa tvsh, procedurë për të cilën është shpallur fitues BOE “V.N.I.S” dhe “N.” shpk, për vlerën prej 57,040,969 lekë, me diferencë nga fondi limit prej 148,981 lekë, OE “V.N.I.S” shpk, ka rezultuar se ndodhet në kushtet e keqinformimit për qëllime kualifikimi duke paraqitur dokumente të rreme apo pa vërteta.

Përshkrimi i shkakut për përjashtim nga prokurimet të OE

Lidhur mbi disponueshmërinë e certifikatës ISO 28000:2007, “Ndërtimin dhe rinovimin e ndërtimeve civile dhe industriale, infrastrukturës rrugore, autostrada, mbikalime, hekurudha, punime nëntokësore, ura e vepra arti, punime ne diga, hidrocentrale, sisteme te ujësjellësve dhe ujërave te zeza. Mirëmbajtje rrugësh rutine dhe ndërtesash civile dhe industriale”.

Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistem SEP, rezulton se të dy operatorët ekonomik “N.” shpk dhe “V.N.I.S” shpk disponojnë certifikatën ISO 28000:2007 “Certificate of conformity” për “*Ndërtim dhe rinovim i ndërtimeve civile dhe industriale, infrastrukturë*

rrugore, autostrada, mbikalime, hekurudha, punime nëntokësore, ura e vepra arti, punime në diga, hidrocentrale, sistemeve të ujësjellësve dhe ujërave të zeza. Mirëmbajtje rrugësh rutinë dhe ndërtesash civile dhe industrial”.

Nga verifikimi on-line në faqen zyrtare të kompanisë certifikuese AQSCERT (Certifications & Inspections body) www.aqscert.org, në rubrikën “Certifikatat e mia” rezulton se OE “N.” shpk, disponon certifikatën ISO 28000:2007 me nr. AQS/SSC/15272017, me të dhënat e poshtëshënuara, të cilat rezultojnë të njëjta me atë të ngarkuar në sistem nga ky operator.

Emri i Kompanisë: “N.” Sh.p.k. NIPT: K...I

Adresa: Rruga ..., Tirane, Albania

Nr. i Certifikatës.: AQS/SSC/15272017

Standarti: ISO 28001:2007

Fusha EN: Construction and renovation of civil and industrial constructions, road infrastructure, highways, overpasses, railways, underground works, bridges, works of art, works on the dams, hydropower, water supply systems and sewerage. Routine maintenance of road and civil and industrial building.

Fusha AL: Ndërtim dhe rinovim i ndërtimeve civile dhe industriale, infrastrukturë rrugore, autostrada, mbikalime, hekurudha, punime nëntokësore, ura e vepra arti, punime në diga, hidrocentrale, sistemeve të ujësjellësve dhe ujërave të zeza. Mirëmbajtje rrugësh rutinë dhe ndërtesash civile dhe industriale.

First Issue Date: 13/02/2017

Data e Modifikimit: 08/02/2019

Vlefshmëria: Valid

Data e Skadencës: 12/2/2020

Lidhur me OE “V.N.I.S” shpk po nga verifikimi on-line në faqen zyrtare të kompanisë certifikuese AQSCERT (Certifications & Inspections body) www.aqscert.org, në rubrikën “Certifikatat e mia” rezulton se OE “V.N.I.S” shpk, nuk disponon certifikatën ISO, edhe pse në SEP ky operator ka ngarkuar certifikatën ISO 28000:2007 me nr. AQS/PPS/16192017. Për këtë operatori, pas plotësimit të rubrikave: Emri i kompanisë, AQS, Standarti dhe Certificate, dhe pas dhënies së komandës “Kërkim” rezulton se del shënimi se: **Certifikata nuk u gjet. Ju lutem kontaktoni info@aqscert.org.**

Sa më sipër rezulton se ky operator ekonomik nuk disponon certifikatën ISO 28000:2007 me nr. AQS/PPS/16192017. Në sistemin elektronik të prokurimeve por edhe në zyrën e protokoll arkivit të bashkisë, nuk rezulton të jetë bërë apo dokumentuar ndonjë kërkesë e Bashkisë dhe më saktësisht e KVO dhe Titullarit të AK, lidhur me vërtetësinë e këtij dokumenti të ngarkuar në sistem nga ky OE, pra nuk ka asnjë të dhënë se mbi çfarë bazë KVO ka vlerësuar përmbajtjen e këtij dokumenti përsa kohë nga kompania certifikuese për këtë subjekti dhe certifikatë, nuk gjendet informacion.

Për këtë kompani në sistem rezulton vetëm certifikata:

Emri i Kompanisë: "V.N. I.S" SHPK NIPT: K...Q

Adresa: Lagjia ..., Diber, Albania

Nr. i Certifikatës.: AQS/SSC/19642017

Standarti: ISO 28001:2007

Fusha EN: Construction and renovation of civil and industrial constructions, road infrastructure, highways, overpasses, railways, underground works, bridges, works of art, works on the dams, hydropower, water supply systems and sewerage. Routine maintenance of road and civil and industrial building.

Fusha AL: Ndërtim dhe rinovim i ndërtimeve civile dhe industriale, infrastrukturë rrugore, autostrada, mbikalime, hekurudha, punime nëntokësore, ura e vepra arti, punime në diga,

hydrocentrale, sistemeve të ujësjellësve dhe ujërave të zeza. Mirëmbajtje rrugësh rutinë dhe ndërtesash civile dhe industriale.

First Issue Date: 13/06/2017

Data e Modifikimit: 18/02/2019

Vlefshmëria: Valid

Data e Skadencës: 12/6/2020

Po ashtu nga verifikimi i lirë i të dy certifikatave të OE "N." shpk, i cili disponon certifikatën ISO 28000:2007 me nr. AQS/SSC/15272017 e cila rezulton dhe në sistemin e AQSCERT, si dhe Certifikatën e "V.N.I.S" shpk, e cila vetëm në SEP ka ngarkuar certifikatën ISO 28000:2007 me nr. AQS/PPS/16192017, certifikatë për të cilën AQSCERT në faqen zyrtare on-line nuk jep informacion duke dalë me shënimin "Certifikata nuk u gjet" rezulton se në të dy rastet certifikatat e lëshuara kanë dy nënshkrime në fund të tyre njëri me shënimin "technical Direction" dhe tjetri "For certification body", nënshkrime të cilat janë idem me njëra tjetrën, duke mos u kuptuar nëse janë nënshkrime elektronike ose jo (edhe pse në dokument nuk ka ndonjë rubrikë që sqaron formën e nënshkrimit të tyre nga personat përgjegjës).

Sa sipër, duke qenë se dokumentacioni i ngarkua në SEP nga OE "V.N.I.S.", nuk rezulton në sistemin e AQSCERT dhe se paraqet të dhëna të njëjta me certifikatën ISO të OE tjetër pjesëmarrës në BOE "N." shpk, kërkojmë Heqjen e licencës profesionale" operatorit ekonomik "V.N.I.S." shpk.

F. KALLËZIM PENAL:

Bazuar në gjetjet dhe aktet e administruara në dosjen e auditimit, në referim të Ligjit nr. 7905 datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale" i ndryshuar, neni 281 të ndryshuar, Kodin Penal, neni 186 "Falsifikimi i dokumenteve", neni 186/a "Falsifikimi kompjuterik", neni 190 "Falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve" Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar KLSH me shkresën nr. 1434/12, datë 23.9.2019, ka dërguar për Indicie Penale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, administratorin e shoqërisë ndërtimore "V.N.I.S." shpk.

Shënim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar", i ndryshuar, Indicia Penale nuk publikohet.

G. Kontratat e punimeve të lidhura midis Bashkisë Fushë-Arrëz dhe operatorëve ekonomik të shpallur fitues në procedurat e prokurimit, zbatimi i të cilave është në proces (*si pasojë e zgjatjes së afateve të punimeve*), do të jenë objekt në auditimin e radhës që do kryhet në Bashkinë Fushë-Arrëz.

Në rastin e fillimit të procedurave gjyqësore në funksion të zbatimit të këtij rekomandimit për "Masa për shpërblim dëmi", nga ana e Bashkisë Fushë-Arrëz, të kërkohet prezenca e KLSH-së, si palë e tretë në proces gjyqësor, duke informuar njëkohësisht KLSH-në, në lidhje me ecurinë dhe zhvillimet përgjatë procesit gjyqësor.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë projektvendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore dhe Departamenti i Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë të Auditimit

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R